



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Štrpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 29/12/2022 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e jashtëzakonshme kuvendit e mbajtur me 13.12.2022

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





Република Косово – Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Општина Штрпце

Комуна е Штѐрпѐс

Municipality of Strpce



РЕПУБЛИКА Е КОСОВЕС
ОПШТИНА ШТРЕПЦЕ

01-020/08-30/23
Nr. i fq. 1
Datum 04.01.2023.
Data 04.01.2023.
ŠTRPCE - SHTËRPECË

PROCESVERBAL

Nga seanca e parë e jashtëzakonshme e KK të Shtërpecës, e mbajtur më 13.12.2022. duke filluar nga ora 11:00.

Rendi i ditës:

1. Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksat komunale

Seanca e jashtëzakonshme e KK të Shtërpecës filloi me konstatimin e kryetarit të Kuvendit, z. Predrag Grbiq se janë të pranishëm 14 këshilltarë, ka theksuar se kjo është seanca e parë e jashtëzakonshme, duke sqaruar më tej se ka dallim në thirrjen e seancave të jashtëzakonshme dhe të rregullta, ku për seancat e rregullta ftesat dërgohen në ditën e 7-të të punës para seancës, dhe për seancat e jashtëzakonshme në datën 3. të punës dhe se me ato të jashtëzakonshme ka edhe dallimin se ai që e thërret seancën ka të drejtë të përcaktojë rendin e ditës. Ai më tutje theksoi se ky është rishikimi i dytë i kësaj rregulloreje dhe se nuk ka ndodhur për shkak të gabimit të KK të Shtërpecës, por të Ministrisë së Shëndetësisë. Ai po ashtu tha se rekomandimet kanë ardhur nga ministri të ndryshme, por nuk ka ndodhur me Ministrinë e Shëndetësisë, kështu që ata na kanë dërguar rekomandimet e tyre pas miratimit të dytë të kësaj rregulloreje. Drejtori i administratës z. Havzi Ahmeti ka sqaruar sot të gjithë situatën lidhur me këtë pikë. Ai ka treguar se i është

drejtuar me shkrim Ministrisë së Shëndetësisë për ti shpjeguar pse ka ndodhur kjo, por se nuk ka marrë përgjigje me shkrim dhe se më vonë ka folur në telefon dhe në atë mënyrë i është konfirmuar se ka pasur një gabim që nuk e kanë vërejtur me kohë dhe se nuk kanë pasur kohë ta shqyrtojnë Rregulloren brenda afatit të paraparë ligjor dhe se thjesht ka pasur nevojë që të reagojnë më vonë, pas miratimit tonë të dytë. Ai tutje theksoi se fjalë është për dy certifikata mjekësore, njëra për patentë shofer dhe tjetra për lidhjen e marrëdhënies së punës, e cila sipas Rregullores së miratuar nga Kuvendi është 18€ dhe duhet të jetë 20€. Pastaj tha se kemi marrë një vërejtje nga Ministria e Arsimit, ku ka marrë edhe një shkresë ku thuhet se ka pagartësi në Rregullore, por i ka kontaktuar dhe u ka thënë se nuk ka pasur dështim procedural apo ligjor dhe më vonë ka marr përgjigjen se gjithçka është në rregull dhe se ligjshmëria e Ministrisë së Arsimit të dhe se për këtë arsye nuk do të miratohet. Ai në fund theksoi se komuna po përpigjet që të gjitha aktet komunale të jenë në përputhje me ligjin dhe kërkoi nga këshilltarët që ta votojnë këtë Rregulloren në mënyrë që ta dorëzojnë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të kërkojnë që ta konfirmojnë ligjshmërinë e saj, për të mund ta zbatojnë atë. Megjithatë nuk pati pyetje, Kryetari i Kuvendit z. Predrag Grbiq e mbylli seancën e jashtëzakonshme.

Procesmbajtësi
Stafa Marković

Kryesuesi i K.K.
Predrag Grbiq

